

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar me:	26.03.2025	
Primljen:		
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
01-052/01-13478		



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Zyra e Kryetarit të Komunës

Procesverbali i draft-Statutit të Qendrës për Punë Sociale

Procesverbal i draft Statutit të Qendrës Për Punë Sociale

INFORMATË RRETH NJOFTIMIT

HYRJE

Në mbështetje të neneve 13, 58 dhe 68 par 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40, 41 dhe 67 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021 Udhëzimi administrativ UA Nr.04/2023 për administratë të hapur në komuna, Rregullores mbi Transparencën në Komunën e Lipjanit Nr. 15-353-35739, e datës 30.06.2021 si dhe Planit të Veprimit për Transparencë në Komunë dhe me qëllim të nxitjes dhe sigurimit të pjesëmarrjes së qytetarëve dhe palëve të tjera gjatë procesit të politik bërjes dhe vendimmarrjes së Kuvendit të Komunës së Lipjanit, Komisioni për hartimin e Rregullores për Transparencë në Komunën e Lipjanit të veprimit dhe zyrtari përgjegjës për menaxhimin me Platformen e Konsultimeve Publike dhe Koordinimin e zbatimin e konsultimit publik në Komunën e Lipjanit kanë shpallur në:

KONSULTIM PUBLIK

Draft-Statutit të Qendrës për Punë Sociale

Njoftimit i është bashkangjitur edhe linku i konsultimeve publike dhe linku i plafotimes për konsultime publike të Qeverisë së Kosovës, ku ka qenë në diskutim publik Draft Statuti si edhe informatë shtesë se kujt i adresohen komentet.

Shih linjet:

<https://lipjan.rks-gov.net/dokumentet-ne-konsultim-publik/>

<https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=42776>

Procesverbal i draft statutit të Qendrës Për Punë Sociale

INFORMATË RRETH DEBATIT PUBLIK

Nën drejtimin e drejtoreshes së QPS-së Makfirete Shamolli njëherit edhe Kryesuese e Komisionit për hartimin e draft statutit të Qendrës Për Punë Sociale, u hap takimi me ç'rast ka përvendetur të gjithë të pranishmit duke i falenderuar për pjesëmarrje, duke thënë se ky draft status është hartuar në përputhje me Legislacionin dhe sugjerimet, kërkesat dhe kontributet e përfaqësuesve të ndryshëm nga Komuna e Lipjanit,

Për realizimin e këtij draft statuti, Kryetari i Komunës së Lipjanit ka marrë vendim për themelimin e komisionit hartues të Draft Statutit të Qendrës për Punë Sociale-Lipjan siq vijon:

1. Makfirete Shamolli – kryesuese
2. Valdete Muji – anëtare
3. Lorik Bërbatovci – anëtar
4. Zyrafete Mavriqi – anëtare
5. Gafurr Hetemi- anëtar

Konsultimi publik u zhvillua në prezencën e një numër të konsideruar të pjesëmarrësve, me ç'rast kryesuesja Shamolli ka theksuar se me qëllim që t'i ofroj publikut qasje të lehtë në mbikëqyrjen dhe zbatimin e politikave nga organet e komunës si dhe rritjen e mundësive të pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendimarrëse, ka prezantuar draft statutit e QPS duke thënë se Procesi i hartimit e deri te miratimi i këtij dokumenti nga Kuvendi i Komunës i Lipjanit kemi kaluar nëpër disa faza, nëpër të cilat janë zhvilluar aktivitete të ndryshme.

Kryesuesja Shamolli, duke e prezantuar këtë draft statut ka thënë se Komuna e Lipjanit është komuna në të cilën jetojnë rreth 57605 banorë dhe se Hartimi i draft statutit ishte përpjekje e përbashkët e grupit punues, për hartimin e e këtij drafti, nën kryesimin e zyrtarës nga QPS me përkrahjen e zyrës Ligjore dhe një spektri të gjërë të partnerëve

Draft Statuti i QPS është një prej dokumenteve të rëndësishme të Komunës së Lipjanit për Qendrën për punë sociale, hartimi i së cilës ka ndjekur një proces të gjatë diskutimesh dhe kontributesh konkrete të shumë institucioneve relevante që punojnë në këtë fushë. Përfshirja dhe kontributi i tyre kanë dhënë frytin e punës që gjendet në faqet e këtij dokumenti.

Procesverball i draft statutit të Qendrës Për Punë Sociale

INFORMATË RRETH DEBATIT PUBLIK

Ky draft statut është hartuar bazuar kryesisht në Ligjshmërinë, sugjerimet, kërkosat dhe kontributet e përfaqësuesve të ndryshëm nga Komuna e Lipjanit, të cilët janë caktuar nga vet komuna, si zyrtarë të drejtoreve të ndryshme komunale, si dhe përfaqësues të OJQ-ve dhe të grupeve avokuese që merren me çështjet e kësaj natyre në këtë komunë për të krijuar një rregullativë organivave për institucionin e që objekti i rregullimit ka qenë: nacioni, emërtimi, selia, simbolet, statusi juridik prezantimi dhe përfaqësimi, kompetencat dhe përgjegjësitë, veprimtaria dhe shërbimet, pronësia, buxheti dhe financat, transparencë, konfidencialiteti, etika dhe kompetenca në përcaktimin e taksave për shërbime administrative në kuadër të QPS-së .

Tutje, kryesesa Shamolli, tha se në pjesën e parë, ka përcaktuar qëllimin dhe objektin e rregullimit duke përfshirë edhe rolin e këtij draft statuti. Për të gjitha fushat e përfshira në këtë draft statut është bërë prezantimi i ndryshimeve dhe rolit sipas objektit të trajtimit, për secilin kapitull në rregullim të strukturës organizative të QPS.

Diskutimi u bë në mënyrë të hapur dhe u diskutuan shumë qështje, lidhur me Draft statutin e QPS-ës.

Gjatë këtij debati ka pasur angazhime nga të pranishmit, ku është diskutuar për çështjet të ndryshme dhe kanë kërkuar nga komisioni sinqerim rreth këtij dokumenti.

Ne po i paraqesim pyetjet qe janë parashtruar gjatë konsultimit publik të dt. 11.03.2025



Procesverball i draft statutit të Qendrës Për Punë Sociale.

INFORMATË RRETH DEBATIT PUBLIK

Pytje/komente shtesë:

Kryesuesja e komisionit për hartimin e dtaft –Statutit të QPS-së, njëherit edhe prezantues e kemi kemi që debat publik ka hapur debatin duke komentuar se:

Draft Statuti i QPS-ës nga komisioni hartues ka respektuar dispozitat e Ligjit për SHSF, kur është fjala për drejtuesin e Institucionit, andaj në vend të drejtiesit të QPS-ës është diskutuar nga ana e saj të ri-kthehet formulimi i bazuar në ligjin bazik sipas pikës 5, të nenit 52 të Ligjit për SHS, pra menaxhohet nga Drejtori i Qendrës për Punë Sociale dhe jo menaxhohet nga Udhëheqësi/a i/e Institucionit. siç edhe ka draftuar këtë draft komisioni hartues.

Të njejtin ka theksuar Zyra Ligjore që do ta përmirësoj këtë lëshim të cilin vet zyra ligjore e ka ndryshuar në Draft Statutin e komisionit gjatë procesit të korigimit, e që në këtë debat publik e ka komentuar duke evidentuar si lëshim që do të ri-kthehet sipas punes së komisionit hartues dhe në perputhje me Ligjin bazik. Ka potencuar Vlora Krasniqi-Zyra Ligjor.

Komenti i mirëpritur dhe i kërkuar edhe nga vet komisioni hartues që Drejtuesi i Institucionit, QPS të jetë sipas legjisacionit dhe funksionit të QPS-së.



Nga Drejtoresha e QPS njëherit edhe kryesuese e këtij komisioni hartues të Draft Statutit të QPS-ës është kërkuar korigimi në nenin 5 pika 5 e Statutit , që në vend të vulen së saj të jetë vulat e saj sepse QPS ka ligjërisht dy vula (Vulen katrore hyrëse dhe dalëse, dhe Vulën e rrumbullakët në administrim e që si komision i kemi paraparë në draft Statut. Zyra ligjore ka miratuar këtë koment duke potencuar në debat publik se është bërë një lëshim teknik (Vlora Krasniqi-Zyra Ligjore)- dhe ka kërkuar të mbetet ashtu sipas Ligjeve vulat e saj.

Zyra ligjore ka miratuar këtë koment duke potencuar në debat publik se është bërë një lëshim teknik (Vlora Krasniqi-Zyra Ligjore)- andaj të mbetet ashtu sipas Legjisacionit vulat e saj.

Procesverbali i draftit statutit të Qendrës Për Punë Sociale.

INFORMATË RRETH DEBATIT PUBLIK

Pytje/koment shtesë:

Xheneta Isufi, Zyrtare e Lartë për Mirëqenie Sociale,

A do të duhet të rregullohet edhe pjesa e pozitave të dy shërbimeve te QPS, pasi qe u prezantua vetëm si një udheheqes (Drejtori) dhe jo udheheqes te dy shërbimeve?

Nga komision i punues i draft-statutit të QPS-ës u mirëprit komenti dhe pernjegjja u nderlidh me pyetjen praprake, te cilen e kishim dhënë si komision per drejtuesin.

Pyetja është me vend: komisioni i hartimit të draft-statutit ka draftuar strukturen me strukturen ekzistuese të shërbimeve egzistuese të cilat duhet të kenë shërbimet edhe udhëheqësit e tyre, siq ka funksionuar deri më tani QPS, por zyra ligjore gjatë korigjimit e ka modifikuar draft statutin duke mos perfshirë shërbimet në në strukturën organizative të QPS-së, sipas kësaj zyre është e rregulluar me organogramin e Komunës në përputhje me dispozitat përkatëse ligjore dhe mund të ndryshohet dhe plotësohet, varësisht nga ndryshimi dhe plotësimi i dispozitave ligjore që e rregullojnë këtë çështje.

Shpresojmë që komenti të mirret për bazë dhe Zyra Ligjore të inkorporojë sygjerimet dhe komentet që janë në përputhje me qështjen e ngritur rreth strukturës dhe ushëheqësve të QPS-së.

Konsideroj që deri më tani QPS, nuk ka pasur ndonjë propozim për ndryshimin e strukturës eksistuese dhe ndonjë akt nënligjor nga Qeveria, për ristukturimin e numrit dhe llojit të pozitave dhe shërbimeve në QPS. Ka thënë kyesuesja e këtij grupi punues.

Lorik Bërbatovci, Udhëheqës i sektorit nga Drejtorati, Rini dhe Sport,

Me Ligjin e SHSF është Institucion, ndersa sipas Ligjeve të Administratës per zyrtarë publik konsiderohet si sektor, e qe konsiderohet se duhet të mirret Ligji Bazë dhe struktura ekzistuese e QPS-së, që sipas nenit 52, pika 7 do të përcaktohet riorganizimi, lloji i dhe numri i profesionistëve në strukturën e QPS-së.

Pika 7 ku permendet edhe pjesa e rregullimit te ketij statuti sepse mendoj se në Kuvend nuk do të konsiderohet e drejtë nëse bie ndesh me strukturën ekzistuese dhe dispozitat Ligjore që përmendëm për riorganizimin e mundshëm të QPS-së me akt nënligjor nga Qeveria.

Commented (All): Se njojte sylloje që shtypet përshtypet përfundimisht se QPS nuk ka ndryshuar, por që konsiderohet se është një strukturë e re e cila ka rastet e varet se është e rregulluar me ligjin e riorganizimit, që është i cili qëndron në kufijtë e QPS-së.

Procesverbali i draftit statutit ië Qendrës Për Punë Sociale.

INFORMATË RRETH DEBATIT PUBLIK

Përgjegjje:

Pyetja dhe komenti rreth ligjeve është i drejtë, sepse QPS-së sipas dispozitave të lart cekura është e vlefshme që QPS është Institucioni dhe jo Sektor, nuk trajtohet njëjtë me aktet nënligjore relevante të administratës së qytetit në ligjin bazik për Shërbime Sociale.

Komisioni punues në draft Statutin e QPS-sës e ka paraparë strukturën aktuale të QPS-sës, por ndryshimet kanë ndodhur nga Zyra ligjore, sipas së cilës zyre është konsideruar se Struktura, udhëheqja dhe organizimi i brendshëm i QPS-së është rregulluar me organogramin e komunës në përputhje me dispozitat përkatëse ligjore dhe mund të ndryshohet dhe plotësohet varësisht nga ndryshimi dhe plotësimi i dispozitave ligjore që e rregullojnë këtë **çështje**.

Ndërsa Kryesuesja e Draft Statutit statutit të QPS-së potencoi se deri në ndryshimin e strukturës me akte Ligjore administrative nga Komuna dhe nën ligjore nga QPS, konsideroj se duhet të trajtohet si strukturë aktuale e QPS-së, e që realist pika 7 e nenit 52 LSHSF Organizimi, përgjegjësitë, lloji dhe numri i profesionistëve si dhe funksionimi i Qendrës për Punë Sociale vë në pyetje atëher kur miratohet akti nënligjor i propozuar nga Ministria dhe të miratuar nga Qeveria, e që e kemi cekur në draftin filletar, të statutit adresuar Zyrës Ligjore në Komunë.

Commented [A2]: Sevdi Syla- sipas sturkures pse nuk eshte QPS ne kuader te QPS si sturkure por ne kudë te Komunes?

Pytje/koment shtesë:

Muhamed Qeriqi, pjesë e OJQ-ve, propozon që të vendoset edhe shërbimi administrativ.

Pergjegjja e të njejit u nderlidh me pergjegjjen e pyetjes së tretë, e cila ka të bëjë me qështje organizative, e që komisioni në draft statut e ka paraparë, por si pjesë integrale e ligjeve të administratës ka pas korigim sipas zyres ligjore, e që e njetja nuk e ka perfshirë strukturen ne ketë statut, por ka potencuar se është e pëfshirë në Stukturën Organizative të Komunës.

Pytje/koment shtesë:

Sevdije Syla, Zyrtare për Shërbime Sociale,

Sipas sturkurës pse nuk është QPS në kuadër të QPS si sturkure por në kudë të Komunes?

Përgjegjja ishte se struktura ishte e draftuar nga komisioni i hartimit të Draft Statutit, e që kryesuesja e ketij draft statuti gjatë pergjegjjes potencoi se QPS menagjon dhe admistron me sherbimet e sajë drejtperdrejt, andaj edhe në draft statutin e QPS është paraparë ky shërbim, por që Zyra Ligjore ka paraparë që struktura dhe organizimi i brendshëm i QPS të jetë pjesë e organogramit në strukturën e Komunës në përputhje me dispozitat përkatëse ligjore aktuale dhe mund të ndryshohet dhe plotësohet varësisht nga ndryshimi dhe plotësimi i dispozitave ligjore që e rregullojnë këtë **çështje** në të ardhmën.

Commented [A3]: Sevdi Syla- sipas sturkures pse nuk eshte QPS ne kuader te QPS si sturkure por ne kudë te Komunes?

Driton Sadiku, Drejtor i Shkollës "Ismajl Luma"

Komentoi se me kët dreft statut është bërë një punë e mirë dhe se ky draft statut ka vlerë, për shkak të veprimtarisë së QPS-së, njëkohësisht uroi që ky draft statut të kaloj në Kuvend

Procesverbali i draft statutit të Qendrës Për Punë Sociale.

INFORMATË RRETH DEBATIT PUBLIK

Takimi filloi në oren 10:00 de mbaroi në ora 12:00

Metodat e Konsultimit	Datat/kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve/konsultimin publik-kontribuuesve
30 ditë pranohen		46
30 ditë		

Në këtë takim konsultativ kanë marrë pjesë 46 pjesëmarrës, prej tyre femra 35 dhe 11 meshkuj.

Bukurie Zejnnullahu-Jashari

Zyrtare përgjegjëse për kordinimin e konsultimeve publike